

Raporti për azilin, 2023

Përmbledhje ekzekutive





© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), 2023

As Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), as ndonjë person që vepron në emër të EUAA-së nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të cilat i përmban ky botim.

Fotografia e kopertinës: Adobe Stock #[457573540](#)

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2023

PDF ISBN 978-92-9403-227-0 doi: 10.2847/717680 BZ-AH-23-001-SQ-N ISSN 2600-3139

Ribotimi autorizohet vetëm nëse bëhet i ditur burimi. Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat EUAA-ja nuk ka të drejta autori, duhet të merret leje drejtpërdrejt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

Raporti për azilin, 2023

Raporti vjetor për gjendjen e azilit në
Bashkimin Evropian

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrik 2023



Parathënie

Mbrojtja ndërkombëtare dhe e përkohshme mbetën në plan të parë të diskutimeve të politikave gjatë gjithë vitit 2022, me një shifër të kombinuar prej 5 milionë personash që kërkonin mbrojtje të cilët mbërritën në Evropë. Në total përfshihet numri i kërkesave për azil që u rrit në pothuajse 1 milion, përveç mbi 4 milionë regjistrimeve për mbrojtje të përkohshme nga personat që largoheshin nga lufta në Ukrainë. Natyrisht, madhësia e fluksit i testoi sistemet kombëtare të azilit dhe pritjes në nivele të reja, dhe vendet e BE+ u përballën me gjetjen e zgjidhjeve të shpejta, por të zbatueshme.

Zhvillimet në mbrojtjen ndërkombëtare në vitin 2022 theksuan rëndësinë e krijimit të një arkitekture efektive mbrojtëse me pjesëmarrjen e shumë palëve të interesit. Siç u prezantua në këtë raport, institucionet e BE-së vazhduan përpjekjet e tyre për të çuar përpara reformën e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS) dhe për të nxitur më tej bashkëpunimin praktik midis vendeve të BE+ mbi bazën e solidaritetit dhe përgjegjësisë. Ata gjithashtu luajtën rol kryesor në zhvillimin e një përgjigjeje të orkestruar evropiane ndaj nevojave të personave të shpërngulur nga Ukraina.



Për të përballuar nevojat ekzistuese dhe ato në zhvillim, vendet e BE+ u përgjigjën duke përshtatur politikat dhe praktikën, duke caktuar burime shtesë dhe duke miratuar ndryshime në legjislacionin. Zhvillimet e shumta pozitive janë për t'u vlerësuar dhe përshëndetur. Por në një botë me modele që ndryshojnë shpejt në fushën e migrimit dhe azilit, nuk ka kohë për vetëkënaqësi dhe mësimet e nxjerra në vitin 2022 duhet të shërbejnë si një katalizator për përsosje të mëtejshme. Aktivizimi dhe shtrirja e shpejtë e mbrojtjes së përkohshme tregoi se legjislacioni në fuqi dhe planifikimi për gjendje emergjente, së bashku me vullnetin e gjerë politik, mund të çojnë në reagime të shpejta ndaj krizave humanitare; të ofrojë parashikueshmëri dhe stabilitet për përfituesit; dhe të nxisë konvergencën në praktikën në disa vende. E rëndësishmja, reagimi i BE-së në mbrojtjen e personave të shpërngulur nga Ukraina mund të hapë rrugën në drejtimin e sistemit të azilit të BE-së në tërësi përmes shprehjeve të ngjashme të solidaritetit dhe përgjegjësisë së përbashkët.

Pas një viti të plotë funksionimi me një mandat të zgjeruar, EUAA-ja e mbylli vitin 2022 me një numër të paprecedentë planesh operative për të ofruar asistencë operative dhe teknike kryesisht për shtetet anëtare që kanë presion shpërpjesëtimor mbi sistemet e tyre të azilit dhe pritjes. Siç përcaktohet në Rregulloren e EUAA-së, programi i ri i punës i Agjencisë do të vazhdojë të zhvillohet gjatë vitit të ardhshëm. Zyratari i sapoemëruar i EUAA-së për të Drejtat Themelore do të sigurohet që operacionet e Agjencisë të vazhdojnë t'u përmbahen plotësisht të drejtave themelore, Oficerët Ndërlidhës në Shtetet Anëtare do të kalibrojnë më tej bashkëpunimin me autoritetet kombëtare dhe një Mekanizëm Monitorues do të fillojë në fillim të vitit 2024 për të ndihmuar në harmonizimin e praktikave në të gjithë BE-në. Duke përbushur statusin e saj si qendër e ekspertizës për azilin, Agjencia do të vazhdojë të luajë rol kryesor në përpjekjet evropiane për të ofruar mbrojtje për ata që kanë nevojë.

Nina Gregori
Drejtore Ekzekutive, Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin





Përmbajtja

Parathënie	5
Përmbajtja	6
Hyrje.....	7
1. Zhvillimet globale në fushën e azilit	8
2. Zhvillimet më të rëndësishme në fushën e azilit në Bashkimin Evropian.....	9
3. Mbështetja e EUAA-së në vitin 2022	12
4. Funkionimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit.....	13
4.1. Qasja në procedura	13
4.2. Procedura e Dublinit.....	15
4.3. Procedurat e veçanta për vlerësimin e nevojave për mbrojtje	16
4.4. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të parë.....	16
4.5. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të dytë ose në shkallët më të larta.....	18
4.6. Çështjet në pritje.....	18
4.7. Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare	18
4.8. Aspektet e paraburgimit që përfshijnë azilkërkuesit dhe ish-azilkërkuesit.....	19
4.9. Qasja në informacion.....	20
4.10. Asistenca dhe përfaqësimi ligjor.....	20
4.11. Shërbimet e përkthimit	21
4.12. Informacioni për vendin e origjinës.....	21
4.13. Mungesa e shtetësisë në kontekstin e azilit.....	22
4.14. Përmbajtja e mbrojtjes	22
4.15. Rivendosja dhe pranimet humanitare.....	24
5. Fëmijët dhe personat me nevoja të veçanta në procedurën e azilit.....	25
Vërejtjet përfundimtare	27





Hyrje



Si burim kryesor i informacionit për mbrojtjen ndërkombëtare në Evropë, Raporti vjetor për azilin i EUAA ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve kryesore në fushën e azilit në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, Islandë, Lihtenshtajn, Norvegji dhe Zvicër (vendet BE+).

Pas vështrimit të shkurtër të prirjeve dhe temave kryesore të diskutimit të cilët shoqërojnë shpërnguljet e detyruara në nivel global, raporti përqendrohet te konteksti në Evropë. Në raport paraqiten zhvillimet kryesore në BE dhe nëpër shtete, duke mbuluar të gjitha aspektet e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Jurisprudenca e përzgjedhur përmendet për të treguar si e kanë modeluar gjykatat interpretimin e legjislacionit evropian dhe të atij kombëtar. Gjithashtu, statistikat për treguesit kryesorë nxjerrin në pah prirjet në fushën e azilit në vitin 2022.

Vendet e BE+ u përballën me një numër të jashtëzakonshëm njerëzish në nevojë për mbrojtje në vitin 2022 si rezultat i rritjes së shpejtë të kërkesave për azil të paraqitura në Evropë, shoqëruar me shpërnguljen e detyruar të miliona njerëzve nga Ukraina pas pushtimit rus. Në dritën e këtyre zhvillimeve, BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj mobilizuan një sasi të paprecedentë burimesh për të përmbushur nevojat në rritje për mbrojtje.



1. Zhvillimet globale në fushën e azilit



Nivelet e rritura të konflikteve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë dekadës së fundit vazhduan në vitin 2022. Një kombinim i krizave, duke përfshirë konflikte të reja dhe të vazhdueshme, kriza klimatike, trazira gjeopolitike, dhunë dhe persekutim, bëri që miliona njerëz të largoheshin nga shtëpitë e tyre në vitin 2022. Pushtimi rus i Ukrainës shkaktoi një nga krizat më të shpejta dhe më të mëdha të shpërnguljes së detyruar që nga Lufta e

Dytë Botërore.

Situata të tjera para-ekzistuese dhe të rënda të shpërnguljes në mbarë botën vazhduan ose u rritën, duke e çuar numrin e njerëzve të shpërngulur globalisht në nivelet më të larta historike në vitin 2022, duke arritur afro 103 milionë, siç vlerësohet nga Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Efekte të rënda mbi popullsinë civile u panë në Afganistan, Burkina Faso, Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Etiopi, Mozambik, Mianmar, Nikaragua, Trekëndëshin Verior të Amerikës Qendrore (Guatemala, El Salvador dhe Honduras), rajonin e Sahelit, Siri dhe Venezuelë.

Në këtë sfond, komuniteti ndërkombëtar vazhdoi përpjekjet e veta në zhvillimin e zgjidhjeve për njerëzit në nevojë për mbrojtje. Nëpërmjet bashkëpunimit me shumë palë të interesit, përgjigjet efektive të mbrojtjes iu dhanë personave që largoheshin nga Ukraina brenda afateve të shkurtra kohore. Për sa i përket mbrojtjes ndërkombëtare, në kuadrin e Paktit Global për Refugjatët, komuniteti ndërkombëtar vazhdoi të hartonte dhe zbatonte iniciativa drejt: i) lehtësimit të presionit mbi vendet pritëse; ii) rritjes së vetëmbështetjes të refugjatëve; iii) zgjerimit të qasjes në zgjidhje në vendet e treta; dhe iv) kushteve mbështetëse në vendet e origjinës për kthim të sigurt dhe dinjitoz.

Ndërsa palët e interesuara në mbarë botën vazhdojnë të trajtojnë aspekte të ndërlikuara të modeleve gjithnjë në ndryshim të shpërnguljes, diskursi dhe praktika e mbrojtjes ndërkombëtare zhvillohen për t'u përshtatur nevojave të reja. Ndër çështjet kryesore që mbetën në qendër të vëmendjes në fushën e azilit gjatë vitit 2022 ishin:

- Fokusi te fëmijët dhe të miturit e pashoqëruar;
- Kuptimi dhe përgjigjja më e mirë ndaj nevojave të grave dhe vajzave në kontekstin e shpërnguljes;
- Theksi te shëndeti fizik dhe mendor i personave të shpërngulur si një shqetësim i përditshëm;
- Shpërngulja e shkaktuar nga klima si faktor që gjeneron dhe formon nevojat e mbrojtjes në mbarë botën; dhe
- Marrja në konsideratë e çështjeve të mungesës së shtetësisë në kontekstin e azilit dhe ndërveprimi midis mungesës së shtetësisë dhe nevojave për mbrojtje.



2. Zhvillimet më të rëndësishme në fushën e azilit në Bashkimin Evropian



Pushtimi rus i Ukrainës shkaktoi shpërngulje të detyruar të niveleve të paprecedenta në dekadat e fundit në Evropë dhe shtoi presionin mbi sistemet e pritjes tashmë të mbingarkuara. Ndikimi i luftës pati një efekt të thellë në formësimin e migracionit dhe azilit, dhe natyrisht zuri një vend qendror në politikëbërjen e mbrojtjes në nivel kombëtar dhe të BE-së gjatë gjithë vitit.

Duke reflektuar angazhimin e BE-së për të treguar solidaritet të plotë me Ukrainën, më 4 mars 2022, Këshilli i Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme miratoi njëzëri vendim zbatues të Këshillit për të aktivizuar Direktivën e Mbrojtjes së Përkohshme dhe vendosi mbrojtje të përkohshme për personat e shpërngulur që largoheshin nga lufta në Ukrainë. Komisioni Evropian krijoi Platformën e Solidaritetit, e cila u bë qendra e një reagimi të orkestruar të BE-së. Ai gjithashtu zhvilloi një plan veprimi prej 10 pikash me masat që do të ndërmerren nga Komisioni Evropian, agjencitë e BE-së dhe shtetet anëtare për t'i përbushur nevojat e personave që largohen nga lufta në Ukrainë.

Pas vendimit të Këshillit në mars 2022, vendet e BE-së vazhduan me aplikimin e vendimit zbatues të Këshillit duke prezantuar marrëveshjet përkatëse procedurale dhe të pritjes, duke organizuar fushata informuese dhe duke u dhënë të drejta personave që largohen nga Ukraina. Aktivizimi dhe zbatimi praktik i Direktivës për Mbrojtjen e Përkohshme lejoi status të qartë ligjor për personat që largohen nga lufta në Ukrainë dhe qasje sistematike në të drejtat shoqërues.¹

Me punën aktive të Presidencës Franceze dhe Çeke të Këshillit të BE-së dhe nën koordinimin e Komisionit Evropian, në vitin 2022 u arrit përparim i konsiderueshëm në avancimin e pakos së reformave të përfshira në [Paktin për Migracionin dhe Azilin](#) dhe rritjen e bashkëpunimit praktik ndërmjet vendeve të BE+. Si rezultat, në qershor 2022, Këshilli miratoi mandatet e negociatave për Rregulloret e Skriningut dhe Eurodac-ut, si dhe qasjen e tij të përgjithshme për propozimin për rishikimin e Kodit Kufitar Schengen. Marrëveshja u arrit gjithashtu nga 21 vende për zbatimin e Mekanizmit të Solidaritetit Vullnetar, duke i hapur rrugën përparimit të mëtejshëm në Rregulloren e Menaxhimit të Azilit dhe Migracionit. Mekanizmi parashikon shprehje solidariteti ndaj Shteteve Anëtare që përjetojnë presion të veçantë mbi sistemet e tyre të azilit dhe pritjes nëpërmjet shpërnguljes, kontributeve financiare dhe masave të tjera të mbështetjes.

Në nivel të Parlamentit Evropian, në vitin 2022, raportuesit paraqitën projekt-raporte mbi të gjitha propozimet legjislative të përfshira në Paktin për Migracionin dhe Azilin dhe në Direktivën e rishikuar për kthimin. Në shtator 2022, Parlamenti dhe Presidencat e radhës të Këshillit të BE-së arritën marrëveshje politike për një [udhërrëfyes të përbashkët](#) për negociatat ndërmjet bashkëligjvënësve me qëllim miratimin e propozimeve legjislative përpara përfundimit të periudhës legjislative 2019-2024.

¹ Për një përmbledhje të detajuar të veprimeve të ndërmarra nga vendet e BE+ në zbatimin e mbrojtjes së përkohshme për njerëzit që ikin nga Ukraina, shihni nga EUAA-ja [Ofrimin e mbrojtjes së përkohshme për personat e shpërngulur nga Ukraina:Një vit në rishikim](#).



Menaxhimi efektiv i kufijve të jashtëm dhe ndikimi shoqëruar në funksionimin e duhur të sistemit të Shengenit ishin temat kryesore të diskutimit midis politikëbërësve evropianë. Komisioni Evropian prezantoi një dokument politikash për të nisur një strategji shumëvjeçare për menaxhimin e integruar të kufijve që trajton kontrollin kufitar; aktivitetet e kërkim-shpëtimit; analizën e riskut; bashkëpunimin ndërinstitucional, të BE-së dhe atë ndërkombëtar; kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të paligjshëm; të drejtat themelore; kërkimin dhe inovacionin; dhe arsimimin dhe trajnimin. U bënë gjithashtu përpjekje për të forcuar bashkëpunimin me vendet e origjinës dhe transitit për të trajtuar migracionin e parregullt.

Kufijtë e jashtëm të BE-së vazhduan të përjetonin presion të shtuar, me ardhjet që u rritën ndjeshëm për të dytin vit radhazi. Sipas të dhënave paraprake të mbledhura nga Frontex, 330 000 kalime të parregullta kufitare u zbuluan në kufirin e jashtëm të BE-së në vitin 2022, që përbën një rritje prej 64% krahasuar me vitin 2021. Personat e shpërngulur nga Ukraina nuk janë përfshirë në këto shifra, pasi ata janë regjistruar veçmas. Për të zgjidhur situatën në kufijtë e jashtëm, Komisioni Evropian vazhdoi të ofrojë mbështetje për Shtetet Anëtare të vijës së parë duke ofruar ndihmë financiare dhe përgjigje operationale në koordinim me agjencitë e BE-së, organizatat ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara.

Komisioni Evropian prezantoi dy plane veprimi me një sërë masash operationale për t'u përballur me sfidat e menjëhershme dhe të vazhdueshme përgjatë itinerareve të Mesdheut Qendror dhe Ballkanit Perëndimor. Plani i Veprimit për Mesdheun Qendror përfshin 20 masa të dizajnuara për të reduktuar migrimin e parregullt dhe të pasigurt, për të ofruar zgjidhje për sfidat e reja në fushën e operationeve të kërkim-shpëtimit dhe për të nxitur solidaritetin e balancuar ndaj përgjegjësisë midis shteteve anëtare. Plani i Veprimit për Ballkanin Perëndimor përfshin gjithashtu 20 masa operationale të strukturuar në pesë shtylla. Qëllimi është të forcohet bashkëpunimi për migracionin dhe menaxhimin e kufijve ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë një status unik si vende në procesin e anëtarësimit në BE.

Në vitin 2022, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare vazhduan t'u jepnin ndihmë njerëzve dhe anijeve në rrezik në Detin Mesdhe përmes operationeve të kërkim-shpëtimit. Këto përfshinin emigrantë dhe refugjatë që përpiqeshin të arrinin në Evropë, duke nisur udhëtime kërcënuese për jetën e organizuar nga kontrabandistët që përdornin taktika gjithnjë e më të rrezikshme për të kaluar Detin Mesdhe. Në mungesë të një mekanizmi në mbarë BE-në, të pranuar përgjithësisht dhe të parashikueshëm për ngjarjet e kërkim-shpëtimit, kufizimet e marrëveshjeve dhe praktikave aktuale vazhduan të jenë objektiv i kritikave. Për ato zëra, mungesa e koordinimit në aktivitetet e kërkim-shpëtimit, veprimet e vetmuara nga vendet individuale dhe kriminalizimi i OJQ-ve të përfshira në aktivitetet e kërkim-shpëtimit në Detin Mesdhe shpesh kanë bërë që emigrantët të detyrohen të qëndrojnë për disa ditë në varka.

Në përputhje me një traditë disa dekadash të të qenit aktor kryesor në promovimin e zgjidhjeve të orientuara nga mbrojtja në të gjithë botën, BE-ja vazhdoi bashkëpunimin e saj gjithëpërfshirës dhe reciprokisht të dobishëm me vendet e treta. Aktivitetet e realizuara në kuadrin e dimensionit të jashtëm të politikës së migracionit dhe azilit të BE-së përfshinin trajtimin e shkaqeve bazë të migracionit të paligjshëm; luftën kundër rrjeteve të kontrabandës; bashkëpunimin me vendet e treta për kthimin dhe pranimin sërishmi; punën me vendet partnere për menaxhimin e migracionit dhe kufirit; dhënien e mbështetjes për zgjidhjet e mbrojtjes në pjesë të tjera të botës; dhe zhvillimin e shtigjeve ligjore drejt mbrojtjes në Evropë.



Në rolin e saj për të siguruar interpretimin dhe zbatimin e harmonizuar të legjislacionit të BE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GjDBE) shpalli më shumë se [20 gjykime](#) në vitin 2022, duke mbuluar temat lidhur me:

- qasje efektive në procedurën e azilit;
- procedurën e Dublinit;
- konceptin e kërkesës vijuese;
- pranueshmërinë e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare;
- të drejtën e qasjes në dosjen administrative dhe kuptimin e komunikimit të vendimit “me shkrim”;
- tërheqjen e kushteve materiale të pranimit;
- objektivin e paraburgimit dhe shqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së paraburgimit;
- bashkimin familjar që përfshin të miturit; dhe
- tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare për arsye të sigurisë kombëtare.



3. Mbështetja e EUAA-së në vitin 2022



Më 19 janar 2022, [Rregullorja \(BE\) 2021/2303 për Themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin](#) ka hyrë në fuqi me një mandat të zgjeruar për Agjencinë. Gjatë gjithë vitit 2022, Agjencia dëshmoi rolin e saj si qendër ekspertize për azilin duke zgjeruar mbështetjen e saj operative dhe teknike për të përmbushur nevojat në zhvillim. Pushtimi rus i Ukrainës krijoi nevoja mbrojtjeje në shkallë të gjerë dhe Agjencia u përgjigj shpejt për të ofruar ndihmë për vendet që pranorin një numër të madh njerëzish të shpërngulur nga Ukraina. Si aktor integral në përgjigjen kolektive të BE-së në përmbushjen e nevojave të miliona personave të shpërngulur, EUAA-ja kontribuoi efektivisht në realizimin e zgjidhjeve të mbrojtjes në të gjithë Evropën.

Për të ofruar informacion të bazuar në prova për një spektër të gjerë të publikut, duke përfshirë politikëbërësit, EUAA-ja vazhdoi në vitin 2022 të mbledhë, përpunojë, sintetizojë dhe analizojë informacione mbi tema specifike, zhvillimet më të fundit, temat e reja dhe parashikimet në fushën e azilit. Trajnimi i zhvilluar dhe ofruar nga Agjencia mbështeti zbatimin praktik të CEAS duke ndihmuar zyrtarët e azilit dhe pritjes të përmirësojnë njohuritë, aftësitë dhe autonominë e tyre për të zbatuar procedura efikase dhe të drejta, në përputhje me standardet e BE-së.

Fushë kryesore e punës së EUAA-së është dhënia e ndihmës operacionale dhe teknike, veçanërisht për shtetet anëtare që përjetojnë trysni të shpërpjesëtuar në sistemet e tyre të azilit dhe pritjes. Në vitin 2022, EUAA-ja ofroi mbështetje operacionale për një numër rekord prej 14 shtetesh anëtare të BE-së: Austria, Belgjika, Bullgaria, Qiproja, Çekia, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Holanda, Rumania, Sllovenia dhe Spanja. Mbështetja operacionale për sistemet kombëtare të azilit dhe pritjes në 2022 mbuloi një sërë veprimesh të cilat u përshtatën me kontekstin dhe nevojat specifike në secilin vend, duke përfshirë mbështetjen për të rritur kapacitetet dhe cilësinë e kushteve të pritjes, regjistrimin dhe përpunimin e kërkesave në shkallë të parë dhe të dytë, mbështetjen për risistemimin dhe rritjen e cilësisë dhe standardizimin e procedurës së Dublinit. Agjencia gjithashtu mbështeti shtetet anëtare në realizimin e zgjidhjeve të mbrojtjes për personat e shpërngulur nga Ukraina.

Nëpërmjet bashkëpunimit të saj me vendet e treta, në bazë të udhërrëfyesve dypalësh dhe programeve rajonale të financuara nga BE-ja, EUAA-ja vazhdoi të mbështesë në vitin 2022 dimensionin e jashtëm të CEAS. Udhërrëfyesit për bashkëpunimin dypalësh u zbatuan me [Shqipërinë](#), [Bosnjë e Hercegovinën](#), [Egjiptin](#), [Kosovën](#), [Malin e Zi](#), [Maqedoninë e Veriut](#), [Serbinë](#) dhe [Turqinë](#), ndërsa në nivel rajonal, Agjencia realizoi me sukses aktivitete që përfshinin të gjitha vendet e Afrikës së Veriut dhe Nigerin. Në funksion të mandatit të ri të Agjencisë dhe zhvillimeve gjeopolitike në fushën e azilit, në mars 2023, Bordi Menaxhues i EUAA-së miratoi një [strategji të rishikuar të bashkëpunimit të jashtëm](#).

Rregullorja e EUAA-së prezantoi dispozita për të siguruar që Agjencia t'u përmbahet plotësisht të drejtave themelore kur kryen detyrat e saj. Në vitin 2022, EUAA-ja realizoi aktivitete përgatitore për emërimin e Zyrtarit për të Drejtat Themelore, zhvillimin e Strategjisë për të Drejtat Themelore dhe krijimin e një mekanizmi ankesash, ku çdo person që preket drejtpërdrejt nga veprimet e një eksperti në një ekip mbështetjeje për azilin, dhe i cili konsideron se të drejtat e tyre themelore janë shkelur për shkak të këtyre veprimeve, ose çdo palë që përfaqëson një person të tillë, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim EUAA-së.



4. Funksonimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit



Në dritën e rritjes së madhe të numrit të njerëzve që kanë nevojë për mbrojtje në Evropë dhe sistemeve të ngopura kombëtare të pritjes, vendet e BE+ zbatuan iniciativa legislative, praktike dhe politikash në vitin 2022 për të menaxhuar situatën e luhatshme. Në të njëjtën kohë, u shprehën shqetësime për disa praktika brenda administratave kombëtare të azilit dhe pritjes u nga organizatat e shoqërisë civile, UNHCR-ja dhe organizata të tjera

ndërkombëtare.

4.1. Qasja në procedura



Në vitin 2022, vendet e BE+ pranuan një numër shumë më të lartë kërkesash për mbrojtje ndërkombëtare sesa në vitet e mëparshme. Rreth 996 000 kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare që u depozituan në vendet e BE+ përfaqësonin një rritje me rreth gjysmën në krahasim me vitin 2021 dhe me dy të pestat në krahasim me nivelin e vitit 2019 para KOVID-19. Ndërsa totali i BE+ mbeti shumë nën nivelin më të lartë të vitit 2015, numri i kërkesave i tejkaloi vlerat e vitit 2015 në disa vende (shihni Figurën 1).

Në të gjitha vendet e BE+, 7 nga çdo 10 kërkesa u depozituan në 5 vendet pranuese – përkatësisht Gjermania, Franca, Spanja, Austria dhe Italia (në rend zbritës). Shtetasit e Sirisë, Afganistanit, Turqisë, Venezuelës dhe Kolumbisë kanë paraqitur më shumë kërkesa. Ndërsa nivelet rekorde të viteve 2015 dhe 2016 u nxitën kryesisht nga kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare nga personat që vinin nga Siria, Afganistani dhe Iraku, rritja aktuale rrjedh nga një gamë shumë më e gjerë e kombësive.

Në dritën e rritjes së mbërritjeve dhe kërkesave, vendet e BE+ vazhduan përpjekjet e tyre për të siguruar qasje në mbrojtje, duke menaxhuar në mënyrë efektive kufijtë e tyre. Duke ndjekur tendencat e viteve të fundit, disa shtete anëtare përgjatë kufijve të BE-së futën rregulla të veçanta për të menaxhuar ardhjet masive dhe për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme në situata specifike. Ndërsa qëllimi i masave të tilla ishte të ndihmonin autoritetet në monitorimin dhe menaxhimin e flukseve hyrëse dhe zbulimin e rasteve të kontrabandës, UNHCR-ja, Këshilli i Evropës dhe organizatat e shoqërisë civile komentuan ndikimin në praktikë, duke paralajmëruar rreziqet për të drejtën për azil dhe parimin e moskthimit.


Aktivizimi i Direktivës për Mbrojtjen e Përkohshme gjithashtu shkaktoi ndryshime në proces dhe ndikoi në kapacitetin për të regjistruar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare në mënyra të ndryshme, pasi vendet e BE+ duhej të regjistronin edhe personat që kishin nevojë për mbrojtje të përkohshme. Kjo çoi në disa rregullime në procedurat e regjistrimit dhe strehimit, me qëllim lehtësimin dhe përsheptimin e procesit për personat e shpërngulur nga Ukraina, gjë që ndonjëherë rezultoi me vonesa në qasje në procedurë për azilkërkesit.





Numri më i lartë i të gjitha kohërave i kërkesave në 13 vende të BE+

Figura 1. Kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare sipas vendeve BE+, 2022



Shënim: Mungonin të dhënat vjetore për Islandën. Totali vjetor është llogaritur si shuma e kërkesave mujore.
Burimi: Eurostat [[migr_asyappctza](#), [migr_asyappctzm](#) për Islandën] sipas të dhënave deri më 13 prill 2023.



4.2. Procedura e Dublinit



Zhvillimet drejt një mekanizmi të ri solidariteti për të plotësuar sistemin e Dublinit vazhduan në nivel të BE-së në vitin 2022. Mekanizmi njëvjeçar i solidaritetit vullnetar, i cili u krijua nga Komisioni Evropian pas një marrëveshjeje midis 18 shteteve anëtare dhe 3 vendeve të asociuara, shihet si një mundësi për të hapur rrugën për një zgjidhje më të përhershme sipas Rregullores së propozuar të Menaxhimit të Azilit dhe Migracionit.

Sipas kuadrit ligjor aktual të BE-së, shtetet anëtare, Komisioni Evropian dhe EUAA zhvilluan një udhërrëfyes për të përmirësuar zbatimin e transferimeve sipas Rregullores Dublin III në vitin 2022, dhe shtetet anëtare filluan të aplikojnë zgjidhjet praktike të përcaktuara në udhërrëfyes për të kapërcyer pengesat në realizimin e transferimeve në vitin 2023.

Ndërsa kufizimet e KOVID-19 u hoqën gradualisht në vitin 2022, çështje kryesore për njësitë e Dublinit në vitin 2022 ishte mungesa e personelit – pjesërisht për shkak të faktit se zyrtarët e rasteve të Dublinit u riemëruan për të mbështetur ardhjen e personave që kishin nevojë për mbrojtje të përkohshme – duke e bërë më sfidues trajtimin e ngarkesës në rritje të punës.

Sipas të dhënave provizore që shkëmbehen rregullisht midis EUAA-së dhe 29 vendeve BE+, në vitin 2022 u shpallën 163 000 vendime si përgjigje ndaj kërkesave të nisura në kuadrin e procedurës së Dublinit. Kjo përbënte një rritje me më shumë se dy të pestat krahasuar me vitin 2021, duke rezultuar në totalin më të lartë vjetor që të paktën nga viti 2016. Në përgjithësi, raporti vjetor i vendimeve të marra për kërkesat e Dublinit ndaj kërkesave të paraqitura për azil ishte 16%, në të njëjtin nivel me vitin 2021. Megjithatë disa vendime për kërkesat e Dublinit kishin të bënin me rastet e bashkimit familjar, raporti i qëndrueshëm i vendimeve ndaj kërkesave sugjeron që në vitin 2022 një numër në rritje i azilkërkuësve u shpërngulën nga vendi i parë i mbërritjes në një tjetër për të paraqitur një kërkesë të re (të referuara si lëvizje dytësore) duke ndikuar në ngarkesat e rasteve të azilit në përgjithësi.

Në nivel vendesh, Franca dhe Gjermania vazhduan të merrnin numrin më të lartë të vendimeve si përgjigje ndaj kërkesave të tyre, duke përbërë së bashku mbi tre të pestat të totalit në BE+. Në vitet e mëparshme, Italia nxori numrin më të lartë të vendimeve për kërkesat e Dublinit. Megjithatë, për herë të parë, Austria dhe Bullgaria dolën si vendet e dyta dhe të treta që lëshuan më shumë vendime, duke e kaluar Gjermaninë dhe Greqinë.

Në vitin 2022, shkalla e pranimit për vendimet në përgjigje të kërkesave të Dublinit, e cila mat pjesën e vendimeve që pranojnë përgjegjësinë (shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar) për një kërkesë nga tërësia e vendimeve të shpallura, ishte 60% (6 pikë përqindjeje më e lartë se në vitin 2021). Kjo përbënte një rritje për herë të parë në 5 vjet në nivel të BE+.

Pas rënies në nivele shumë të ulëta gjatë pandemisë së KOVID-19 në vitet 2020 dhe 2021, numri i transferimeve të Dublinit që u zbatuan në 2022 mbeti i ulët. Në përgjithësi, rreth 15 000 transferime u ndërmorën në vitin 2022, gjë që ishte rreth një e shtata më shumë se në vitin 2021, por rreth dy të pestat më pak se shifra e vitit 2019.

Neni 17, paragrafi 1, i Rregullores Dublin III u përdor si referencë rreth 4800 herë në vitin 2022, duke u rritur për herë të parë në 4 vjet, por ende shumë poshtë niveleve para pandemisë. Neni 17, paragrafi 1, është klauzolë diskrecioni, e cila i lejon shtetet anëtare të shqyrtojnë kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga



një person pa shtetësi, edhe nëse shqyrtimi i kësaj kërkesë nuk është përgjegjësi e këtij shteti sipas kriterëve të parashikuara në rregullore.

4.3. Procedurat e veçanta për vlerësimin e nevojave për mbrojtje



Gjatë shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në shkallë të parë, shtetet anëtare mund të përdorin procedura speciale në disa kushte të caktuara, për shembull procedurat e përshpejtuara, procedurat në kufi ose procedurat prioritare, duke respektuar njëkohësisht parimet dhe garancitë bazë të parashikuara nga legjislacioni i BE-së.

Gjatë gjithë vitit 2022, gjykatat kombëtare ndërhyjnë për të vlerësuar dispozitat legjislative, si dhe zbatimin praktik të procedurave të veçanta. Vazhduan shqetësimet për përdorimin e procedurave kufitare dhe rreziqet e përshpejtit bazuar në konceptin e vendit të sigurt dhe kërkesat vijuese.

Në përgjithësi, 76 000 kërkesat vijuese u depozituan në të njëjtin vend të BE+ në vitin 2022, që përfaqësonte një rënie krahasuar me 91 000 kërkesat vijuese në vitin 2021. Raporti i kërkesave vijuese me numrin total të kërkesave ishte 1 në 12, duke përbërë një rënie të dukshme krahasuar me vitin 2021 (kur ishte 1 në 7).

4.4. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të parë



Rritja e numrit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, krahas miliona personave të zhvendosur nga Ukraina që kanë nevojë për mbrojtje të përkohshme, ushtroi presion në rritje në kapacitetin përpunues në shkallën e parë. Vendet e BE+ iu përgjigjën kësaj nevoje duke miratuar masa për të rritur efikasitetin e sistemit të përgjithshëm të azilit dhe për të përshpejtuar procedurën e azilit.

Filloi rekrutimi i stafit të ri dhe riorganizimi i autoriteteve përcaktuese dhe u krijuan zyra territoriale shtesë për të rritur praninë dhe për të lehtësuar qasjen në procedurën e azilit dhe autoritetet kompetente. Disa vende të BE+ prezantuan politika dhe udhëzime prioritare për profile të caktuara, zgjatën afatet kohore për të shpallur një vendim në shkallë të parë dhe shkurtuan ose hoqën disa hapa në procedurë kur rezultati do të ishte i favorshëm për azilkërkesin. Për të përmirësuar dhe përshpejtuar procedurat, disa vende zhvilluan udhëzime të reja të përgjithshme për të vlerësuar kërkesat dhe miratuan politika të reja për rastet e paraqitura nga profile dhe kombësi specifike të azilkërkesve.

Në vitin 2022, autoritetet e azilit në vendet e BE+ shpallën rreth 646 000 vendime të shkallës së parë, që ishte një e pesta më shumë se në vitin 2021 dhe numri më i lartë që nga viti 2017. Në të njëjtën kohë, shumë më tepër kërkesa u parashtruan në vitin 2022 (gjysmë më shumë), veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Deri në fund të vitit 2022, kërkesat tejkaluan vendimet e shkallës së parë me 345 000, duke çuar në më shumë çështje në pritje në shkallë të parë në shumicën e vendeve të BE+ sesa para një viti.




Tre vende të BE+ kanë shpallur gati dy të tretat e të gjitha vendimeve të shkallës së parë në vitin 2022: Gjermania (31%), Franca (20%) dhe Spanja (13%). Këto u pasuan nga Italia (8%), Austria (6%) dhe Greqia (6%). Shumica e vendimeve të shkallës së parë në vendet e BE+ iu shpallën shtetasve të Sirisë dhe Afganistanit, që morën 3 nga 10 vendime (shih Figurën 2). Shtetasit e Turqisë (25 000), Bangladeshit (21 000) dhe Gjeorgjisë (19 000) morën më shumë vendime se ndonjëherë.



Më shumë vendime të shkallës së parë të shpallura në vitin 2022 për pothuajse të gjitha vendet kryesore të origjinës

Figura 2. Vendimet e shkallës së parë në vendet e BE+ sipas 10 vendeve kryesore të origjinës që marrin vendime, 2022 krahasuar me vitin 2021



Burimi: Eurostat [[migr_asydcfsta](#)] sipas të dhënave deri më 13 prill 2023.

Rreth 140 000 kërkesa u tërhoqën në të gjitha instancat në vendet e BE+ në vitin 2022, që ishte dy herë më shumë se në vitin 2021 dhe më së shumti që nga viti 2016. Në përgjithësi, raporti i kërkesave të tërhequra ndaj numrit të përgjithshëm të kërkesave të paraqitura u rrit nga rreth 1 në 10 në 4 vitet e mëparshme në 1 në 7 në vitin 2022. Të paktën katër të pestat e të gjitha kërkesave të tërhequra në vitin 2022 ishin të nënkuptuara. Është e mundur që një azilkërkuar të tërheqë në mënyrë të nënkuptuar kërkesën e tij nga një vend i BE+ për të bërë kërkesë sërish në një tjetër, duke treguar kështu lëvizje dytësore drejt vendeve të tjera të BE+. Në këtë drejtim, ishte një mënyrë veprimi e shumë tërheqjeve të nënkuptuara, dhe rrjedhimisht lëvizjeve dytësore, nga vendet përgjatë itinerarit të Ballkanit dhe vendeve në kufijtë e jashtëm të BE-së.



4.5. Përpunimi i kërkesave për azil në shkallë të dytë ose në shkallët më të larta



Në vitin 2022, zhvillimet në shkallën e dytë në disa vende të BE+ përfshinin vlerësime ose interpretime të reja të së drejtës për të pasur qasje në një procedurë apelimi, si p.sh. kush mund të paraqesë një ankesë dhe kërkesat të cilat një azilkërkues duhet të përmbushë për të pasur qasje në procedurën e apelimit. Qëllimi i apelimeve në rastet e mbrojtjes ndërkombëtare ishte objekt i përmirësimeve të mëtejshme, duke përfshirë kërkesën për të ofruar një shqyrtim *ex nunc* (për të ardhmen) si të fakteve ashtu edhe të pikave të ligjit dhe efektit pezullues të ankesave, për të harmonizuar praktikatat e brendshme dhe dispozitat legislative me dispozitat përkatëse të Direktivës së riformuluar për procedurat e azilit.

Gjykatat ndërhynë për të vlerësuar efektivitetin e mjeteve juridike, ndërkohë që kohëzgjatja e procedurave të ankimit vazhdoi të ishte një aspekt me shqetësim të veçantë, duke çuar në ndryshime legislative të propozuara, të miratuara ose tashmë të zbatuara për të përshpejtuar procedurën e apelimit. Gjykatat gjithashtu shqyrtuan se cili organ kompetent duhet të jetë përgjegjës për ankesën e një vendimi për një kërkesë për azil.

4.6. Çështjet në pritje



Në fund të vitit 2022, gati 899 000 kërkesa për azil ishin në pritje të një vendimi në vendet e BE+, duke u rritur me pothuajse një të pestën krahasuar me një vit më parë. Kjo përfaqësonte shumicën e rasteve në pritje të një vendimi që nga prilli 2020, kur përpunimi i kërkesave u pezullua ose u kufizua rreptësisht gjatë fillimit të pandemisë së COVID-19.

Ndërsa numri i çështjeve të pazgjidhura mbeti relativisht i qëndrueshëm deri në korrik 2022, ai filloi të rritet vazhdimisht më pas, në përputhje me numrin në rritje të kërkesave për azil, ndërsa vendimet në shkallën e parë filluan të mbeten shumë pas numrit të kërkesave në dy tremujorët e fundit të vitit 2022 se në dy të parat. Kështu, numri i çështjeve në pritje ishte shumë më i lartë se ai i para krizës së vitit 2014, duke rritur trysninë mbi sistemet kombëtare të pritjes.

Një kombinim i të dhënave të Eurostat-it dhe Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Gatishmërisë (EPS) të EUAA-së mundëson zberthimin e çështjeve të pazgjidhura në shkallën e parë dhe çështjeve në pritje në shkallën e dytë ose më të lartë. Rezultatet tregojnë se stoku i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura është rritur në shkallën e parë, ndërsa ka vazhduar të ulët në shkallët më të larta.

4.7. Pritja e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare



Viti 2022 ishte padyshim një vit kur sistemet e pritjes në vendet e BE+ testuan kufijtë e tyre, duke u thirrur për të përmbushur nevojat jo vetëm të një numri në rritje të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, por edhe të miliona personave që kishin nevojë për mbrojtje të përkohshme – si rrjedhojë, edhe të atyre që kishin nevojë për strehim.



Sfidë kryesore mbeti mungesa e vendeve të mjaftueshme, megjithëse shtetet anëtare vazhduan të investonin dukshëm në rritjen e kapacitetit pritës. Disa vende tejkaluan të gjitha rekordet e mëparshme të kapacitetit, por kjo ende nuk ishte e mjaftueshme për të ofruar strehim adekuat për të gjithë azilkërkuesit. Sfidat e shumanshme ndonjëherë u ndërlikuan nga metodat dhe problemet e financimit të pamjaftueshëm në bashkëpunim me komunitatet. Vetëm një pjesë e vogël e vendeve të BE+ (p.sh. vendet tranzitore nga ku azilkërkuesit shpesh lëviznin drejt një vendi tjetër të BE+) nuk raportuan probleme me kapacitetin.

Shtetet anëtare hulumtuan mënyra të ndryshme për t'u përgjigjur nevojave në rritje. Disa iu drejtuan aktorëve të rinj për të forcuar sistemin e pritjes, për shembull, përmes përfshirjes më të ngushtë të organizatave të shoqërisë civile, aktorëve komunalë, aktorëve të menaxhimit të fatkeqësive ose aktorëve privatë. Në kuadër të planeve të veta operative, EUAA-ja ndihmoi 10 vende në përmirësimin e sistemeve të tyre të pritjes.

Kushtet e pritjes u përkeqësuan në qendrat e mbipopulluara dhe çuan në kushte nën ato standardet në disa vende të BE+, siç dokumentohet gjerësisht nga organizatat e shoqërisë civile. Gjykatat ndërhyjnë për të përsëritur detyrimet e shteteve anëtare në sigurimin efektiv të kushteve të pritjes. Meqenëse fokusi mbeti në nevojat imediate, si gjetja e vendeve të mjaftueshme të pritjes dhe siguri i kushteve të përshtatshme të jetesës, dukej se ishin zbatuar më pak iniciativa për të lehtësuar qasjen e azilkërkuesve në punësim, orientimin në shoqërinë e re ose qasjen në arsim dhe kujdes shëndetësor.

4.8. Aspektet e paraburgimit që përfshijnë azilkërkuesit dhe ish-azilkërkuesit



Në vitin 2022, të metat në praktikën dhe në kushtet e paraburgimit vazhduan të hetohen nga organizatat monitoruese dhe gjyqësore ndërkombëtare, evropiane dhe vendase si Komiteti i OKB-së Kundër Torturës (CAT), Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (CPT), avokatët vendorë të popullit, GjDBE, Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) dhe gjykatat vendase si dhe UNHCR-ja dhe organizatat e shoqërisë civile. Vendimet e gjykatave nxitën, nganjëherë, procese për të harmonizuar politikat dhe praktikën kombëtare me legjislacionin përkatës evropian.

Kapaciteti i paraburgimit në vendet e BE+ vazhdoi të rregullohej në bazë të nevojave operacionale, kryesisht për të hapur ose planifikuar ndërtimin e objekteve të reja të paraburgimit. Përdorimi i paraburgimit ishte një nga shqetësimet kryesore të ngritura nga organizatat e shoqërisë civile. Në një sërë vendesh, u shprehën shqetësime për praktikën e paraburgimit të azilkërkuesve në kufi, paraburgimin *de facto* në përgjithësi ndërsa shtetasit e vendeve të treta të sapoardhur ishin në pritje për të paraqitur një kërkesë, kushtet në paraburgim dhe pengimi i qasjes në të drejta, si p.sh. qasja në informacionin dhe ndihmën juridike.



4.9. Qasja në informacion



Në vitin 2022, vendet e BE+ vazhduan të rrisin dhënien e informacionit për azilkërkuesit me anë të novacionit dhe përmirësimeve, si platformat dhe faqet e reja të internetit. Përveç autoriteteve kombëtare, organizatat e shoqërisë civile vazhduan të luajnë një rol po aq integral në lehtësimin e qasjes në informacion. Si autoritetet kombëtare ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile bënë gjithnjë e më shumë përpjekje për të siguruar që azilkërkuesit dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare të kishin qasje në informacion në një gjuhë që ata e kuptojnë. Si e tillë, përmbytja u përkthye në disa gjuhë, me fokus të veçantë në disponueshmërinë e informacionit në gjuhën ukrainase dhe ruse.

Grupe të veçanta azilkërkuesish mund të kërkojnë informacion të përshtatur për situatën dhe rrethanat e tyre. Ardhja masive e personave të shpërngulur nga Ukraina krijoi një tablo të re informative; vendet e BE+ ndanë burime të konsiderueshme për të zhvilluar platforma dhe materiale informative të cilat përditësoheshin rregullisht për të ofruar informacionin më të përditësuar dhe më të saktë në një mjedis që ndryshonte me shpejtësi. Autoritetet kombëtare u mbështetën në këtë proces për shembull nga iniciativat nga EUAA ([Who is Who in Temporary Protection](#)) dhe UNHCR (Help Pages). Informacion i ri u zhvillua gjithashtu edhe për shtetasit rusë që kërkonin mbrojtje.

4.10. Asistenca dhe përfaqësimi ligjor



Në vitin 2022, disa vende të BE+ vazhduan përpjekjet për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e asistencës ligjore në të gjitha fazat e procedurës së azilit. Ata nisën nisma dhe projekte të reja, për shembull kontraktimin e avokatëve të specializuar që punojnë në çështjet e azilit dhe ofrimin e mbështetjes shitesë për azilkërkuesit me nevoja të veçanta. Zhvillimi profesional dhe mjete të reja u vunë në dispozicion të praktikantëve ligjorë, me synimin e përgjithshëm për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Përpjekje të konsiderueshme u vunë re edhe në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike gjatë gjithë procedurës së azilit nëpërmjet digjitalizimit dhe ndërlidhjes ndërmjet portaleve të autoritetit përcaktues dhe platformave gjyqësore.

Megjithatë, siç është raportuar në vitet e mëparshme, zbatimi i dispozitave përkatëse të Direktivës së riformuluar për Procedurat e Azilit mbeti një çështje shqetësuese në kufi, në ambientet e paraburgimit dhe në procedurën e apelimit për shkak të informacionit dhe qasjes së pamjaftueshme në asistencë ligjore dhe përfaqësim. Në disa raste, afatet e shkurtra kohore në procedurën kufitare, në procedura të veçanta ose në procedurën e Dublinit kanë rezultuar në ndihmë ligjore të kufizuar, jocilësore ose joekzistuese.

Si përgjigje ndaj pushtimit rus, autoritetet kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile mobilizuan burime për të ofruar mbështetje të menjëhershme për personat e shpërngulur nga Ukraina, duke përfshirë informacionin ligjor dhe ndihmën me përfshirjen aktive të shoqatave kombëtare të avokatëve.



4.11. Shërbimet e përkthimit



Në vitin 2022, vendet e BE+ prezantuan disa iniciativa për të përmirësuar shërbimet e përkthimit në procedurën e azilit, veçanërisht në kontekstin e ofrimit të shërbimeve të duhura për personat e mbijetuar të trafikimit të qenieve njerëzore, për të ndihmuar personat me nevoja të veçanta dhe në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Përpjekjet vazhduan për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të përkthimit përmes trajnimeve, udhëzimeve, mjeteve cilësore dhe materialeve mbështetëse për përkthyesit. U vu re një tendencë në rritje në angazhimin e përfituesve të mbrojtjes si përkthyes në kontekstin e azilit; duke pasur vetë përvojë të drejtpërdrejtë rreth procesit, përkthyesit e tillë ishin në gjendje të ofronin mbështetjen e duhur për azilkërkuesit e rinj.

Për të adresuar ardhjen e personave të shpërngulur nga Ukraina, disa vende të BE+ e shtuan numrin e përkthyesve që flasin gjuhë ukrainase dhe gjuhë ruse dhe prodhuan më shumë materiale informative në ato gjuhë. Këto përpjekje sollën kritika nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat raportuan një sistem me dy nivele në ofrimin e ndihmës për personat që largoheshin nga Ukraina, të cilët morën mbështetje të shpejtë në fushën e përkthimit, dhe azilkërkuesit për azil nga vende të tjera. Shqetësime u ngritën edhe nga organizatat e shoqërisë civile për barrierat gjuhësore dhe kulturore në kufi, për shkak të mungesës së shërbimeve të përkthimit dhe përkthimeve të dobëta të informacionit, gjë që i pengonte migruesit të kuptonin në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e tyre.

4.12. Informacioni për vendin e origjinës



Zhvillimet kryesore në prodhimin e informacionit për vendin e origjinës (IVO) në vitin 2022 u përqendruan në përmirësimin e metodologjive, investimin në teknologji dhe studiuës të rinj, përmirësimin e bashkëpunimit me studiuës të tjerë me bazë në Evropë (për shembull në njësitë kombëtare të IVO-së dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në vendin e origjinës), dhe prodhimin e informacionit me shpejtësi për të adresuar situatat e reja të krizës. Prodhimi i IVO-së vazhdoi të përqendrohej te vendet më të zakonshme të origjinës së azilkërkuesve në Evropë, konkretisht Afganistani, Kolumbia, Siria, Turqia dhe Venezuela. Natyrisht, prodhimi i IVO-së në vitin 2022 u përqendrua edhe në situatën në Ukrainë dhe Rusi.

Një sfidë që dukej se vazhdonte, siç theksohet nga organizatat e shoqërisë civile, lidhet me mungesën e qasjes dhe lehtësisë së përdorimit të bazave të të dhënave të IVO-së dhe mungesës së informacionit në shumë gjuhë, pasi materiali i IVO-së është kryesisht i disponueshëm në anglisht. Për më tepër, duket se ka një mungesë ekuilibri midis vendeve të origjinës për të cilat është i disponueshëm një numër i madh raportesh të IVO-së dhe vendeve për të cilat nuk ka informacion ose nuk ka informacion të kufizuar, si dhe mungesë të dhënash për azilkërkuesit interseksualë dhe situatën në vendet e tyre të origjinës.



4.13. Mungesa e shtetësisë në kontekstin e azilit



Në kontekstin e azilit, mungesa e nënshtetësisë mund të ndikojë në procesin e përcaktimit për një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, si edhe mbrojtjet procedurale të azilkërkuesit. Në vitin 2022, vendet e BE+ bënë ndryshime legjislative dhe politikash për të zgjidhur çështjen e mungesës së shtetësisë, duke përfshirë vendosjen e procedurave të dedikuara për përcaktimin e mungesës së shtetësisë, lehtësimin e qasjes në natyralizim dhe përditësimin e udhëzimeve për përpunimin e kërkesave nga personat pa shtetësi.

Megjithatë, disa sfida dukej se vazhduan, duke përfshirë mungesën e një procesi të përcaktimit të mungesës së shtetësisë në disa vende të BE+ dhe mungesën e ndërgjegjësimit dhe ekspertizës për çështjet lidhur me mungesën e shtetësisë në kontekstin e azilit. Kjo mund të krijojë paqartësi te azilkërkuesit për procesin, për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe mund të shkaktojë identifikim dhe regjistrim të pasaktë.

4.14. Përmbajtja e mbrojtjes



Përmbajtja e mbrojtjes u referohet të drejtave që përfituesit e një forme të mbrojtjes kanë të drejtë në vendin e azilit, si dhe detyrimeve përkatëse. Mbrojtja jepet kur azilkërkuesit marrin vendim pozitiv për dhënien e statusit të refugjatit ose mbrojtjes plotësuese (të referuara edhe si statuset e harmonizuara me BE-në). Shkalla e njohjes i referohet numrit të rezultateve pozitive si përqindje e numrit të përgjithshëm të vendimeve për kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare. Ndërsa format kombëtare të mbrojtjes u japin status mbrojtjeje shtetasve të vendeve të treta, ato statuse – të cilat nuk janë të harmonizuara nëpër vendet e BE+ – nuk përfshihen në llogaritjen e shkallës së njohjes.

Në vitin 2022, shkalla e përgjithshme e njohjes në vendet e BE+ për vendimet e marra në shkallë të parë për kërkesat për azil ishte 39%. Kjo do të thotë se nga 646 000 vendime të shpallura, 252 000 ishin pozitive, duke dhënë kështu ose statusin e refugjatit ose mbrojtjen plotësuese. Shkalla e njohjes u rrit me 5 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2021 dhe ishte më e larta që nga viti 2017. Pjesa më e madhe e vendimeve pozitive në shkallë të parë dhanë statusin e refugjatit (149 000 ose 59% e të gjitha vendimeve pozitive), ndërsa për pjesën e mbetur prej 103 000 çështjesh (41%) u dha mbrojtja plotësuese.


Përtej statuseve të rregulluara në BE, nëse në llogaritje do të futen edhe lejet e qëndrimit për arsye humanitare, shkalla e përgjithshme e njohjes në vendet e BE+ për vendimet në shkallë të parë në vitin 2022 do të ishte 50%.

Ndër 20 kombësitë që morën më shumë vendime të shkallës së parë në vitin 2022, sirianët kishin shkallën më të lartë të njohjes me 93%. Ata u pasuan nga ukrainasit (86%) dhe eritreanët (84%). Grupe të tjera me norma relativisht të larta njohjeje përfshinin shtetasit e Malit (65%), Somalisë (57%) dhe Afganistanit (51%) (shihni Figurën 3).



Sirianët, ukrainasit dhe eritreanët kishin normat më të larta të njohjes në vitin 2022

Figura 3. Normat e njohjes së shkallës së parë për 20 kombësitë kryesore me më shumë vendime të shpallura në vendet e BE+, sipas kombësisë dhe statusit të dhënë, 2022



Shënim: Këto 20 kombësi morën numrin më të lartë të vendimeve të shkallës së parë gjatë vitit 2022 në vendet e BE+. Ato renditen (nga e majta në të djathtë) për sa i përket numrit të vendimeve të marra.

Burimi: Eurostat [[migr_asydcfst](#)] sipas të dhënave deri më 13 prill 2023.

Shtrirja dhe cilësia e të drejtave dhe shërbimeve që marrin përfituesit e mbrojtjes formojnë perspektivat e integritit të tyre e në shoqëritë pritëse. Në vitin 2022, politikat e integritit u orientuan kryesisht te personat që kishin nevojë për mbrojtje të përkohshme nga Ukraina, duke përfshirë lehtësimin e orientimit të tyre social, qasjen në arsim, punësim dhe kujdes shëndetësor, si dhe ofrimin e përfitimeve të mirëqenies sociale.

Tendenca e vërejtur në vitet e mëparshme për të përfshirë një sërë palësh të interesuara dhe për të përmirësuar bashkëpunimin për integritin e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare vazhdoi në vitin 2022 dhe nevoja urgjente në shkallë të gjerë për të ofruar mbështetje integruese për personat në nevojë për mbrojtje të përkohshme e përshpejtoi më tej këtë proces të bashkëpunimit me shumë palë. Kështu, vendet e BE+ pilotuan disa mënyra të reja, novatore për të punuar së bashku në integritin e personave me nevojë për mbrojtje.

Për të mbështetur politikëbërjen e bazuar në prova, aktorë të ndryshëm, duke përfshirë autoritetet kombëtare, mjedisi akademik, institucionet studimore dhe organizatat e shoqërisë civile, vazhduan të vlerësojnë komponentët e programeve të integritit përgjatë vitit 2022. Mësimet e nxjerra nga përpjekjet për të integruar përfituesit e mbrojtjes së përkohshme mund të ofrojnë njohuri të mëtejshme mbi ndikimin e qasjeve të ndryshme ndaj integritit në të ardhmen. Paralelisht, disa vende të BE+ vazhduan me nisma të cilat u ofronin të drejtën e qëndrimit ish-azilkërkuesve që nuk mund të ktheheshin dhe që kishin arritur një nivel të caktuar integriti.

Britja e kërkesave për azil në vitin 2022 ndikoi dhe shkaktoi shpesh vonesa në dorëzimin e dokumenteve të qëndrimit dhe udhëtimit për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, gjë që rrezikonte të vononte qasjen e tyre në shërbime dhe të drejta të tjera. Siç u pa në vitet e mëparshme, gjykatat ruajtën një rol të rëndësishëm në formësimin e interpretimit të arsyeve dhe procedurave për rishikimin ose tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare, ndërkohë që autoritetet gjyqësore shqyrtuan gjithashtu politikat dhe praktikat kombëtare në fushën e bashkimit familjar.

4.15. Rivendosja dhe pranimet humanitare



Pas reduktimit të aktiviteteve e risistemimit gjatë pandemisë COVID 19, shtetet filluan të riaktivizojnë gradualisht programet gjatë vitit 2021 dhe 2022. Në këtë kontekst, vendet e BE+ vazhduan përpjekjet për të përmbushur angazhimet e tyre. Kjo kërkonte përshtatjen e prioriteteve dhe programeve me sfidat e reja gjatë vitit, si kriza e vazhdueshme në Afganistan dhe ardhja masive e personave të shpërngulur nga Ukraina. Presioni akut mbi sistemet kombëtare të pritjes çoi në vonesa në zbatimin e premtiveve të zhvendosjes nga shumë vende të BE+.

Në përgjithësi, roli i organizatave të shoqërisë civile, kompanive private dhe grupeve të komunitetit u përforcua përmes marrëveshjeve të reja pasi ato luajnë një rol të rëndësishëm në pritjen e refugjatëve të shpërngulur dhe në procesin e përzgjedhjes dhe referimit. Për të matur ndikimin e programeve të shpërnguljes, vendet e BE+ dhe organizatat e shoqërisë civile ndërmorën vlerësime për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira.

Në fushën e pranimeve humanitare, përpjekjet u përqendruan kryesisht në ardhjen e shtetasve afganë në rrezik. Përsëri, u zbatuan nismat përkatëse në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.



5. Fëmijët dhe personat me nevoja të veçanta në procedurën e azilit



Meqenëse personat me nevojë për mbrojtje të përkohshme ishin kryesisht gra dhe fëmijë në vitin 2022, vendet e BE+ kishin nevojë të përshtatnin shërbimet mbështetëse të cilat përgjithësisht ishin të orientuara drejt azilkërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare që janë kryesisht burra. Gratë dhe fëmijët që largoheshin nga Ukraina ishin në një rrezik të shtuar për t'u trafikuar, kështu që një numër vendesh të BE+ realizuan fushata për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të parandaluar trafikimin. Ato gjithashtu bënë përpjekje të mëtejshme për identifikimin më të mirë të viktimave dhe ofrimin e mbështetjes së shpejtë dhe adekuate.

Pavarësisht përpjekjeve të vendeve të BE+ për të përmirësuar identifikimin, referimin dhe ndjekjen e hershme, identifikimi i personave me nevoja të veçanta dhe ofrimi i akomodimit dhe mbështetjes në kohë për personat më vulnerabël u bë edhe më sfidues në dritën e sistemeve të mbingarkuara të pritjes. Përveç kësaj, disa shtete anëtare dhe organizata të shoqërisë civile vunë re se azilkërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare mbërritën në BE në gjendjen më të keqe shëndetësore se në vitet e mëparshme.

Gjykatat shpesh ndërhyjnë për të vendosur për një sërë çështjesh që lidheshin me azilkërkuesit me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta shëndetësore, për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen efektive të grave dhe vajzave, dhe për rastet që kanë të bëjnë me pretendimet për orientimin seksual dhe identitetin gjinor (SOGI).

Në vitin 2022, 42 000 kërkesa për azil u parashtruan nga të mitur të pashoqëruar nëpër vendet e BE+, që ishte shifra më e lartë që nga viti 2016. Kjo përbënte një rritje prej tre të pestat nga viti i kaluar, duke tejkaluar paksa rritjen në totalin e kërkesave (+53%). Vetëm dy shtetësi së bashku përbënin dy të tretat e kërkesave nga të miturit e pashoqëruar: pothuajse gjysma u paraqitën nga afganë (20 000) dhe sirianë (10 000).

Më shumë se gjysma e të gjitha kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga të miturit e pashoqëruar janë parashtruar në Austri (13 000 ose 31%), Gjermani (7300, 17%) dhe Holandë (4200, 10%). Si në Austri ashtu edhe në Holandë, si dhe në Bullgari (3400), Francë (1000) dhe Qipro (900), shifrat për vitin 2022 ishin më të lartat e regjistruara (shihni Figurën 4).

Statusi i refugjatit ose mbrojtja plotësuese iu dha pothuajse të gjithë të miturve sirianë të pashoqëruar (96%). Përkundrazi, një pakicë e vogël vendimesh pozitive iu dhanë të miturve nga Bangladeshi (6%).


Rreth 18 000 kërkesa u tërhoqën nga të mitur të pashoqëruar në 20 vende të BE+ që raportuan të dhëna të tilla. Në mënyrë të ngjashme me kërkesat e tërhequra nga azilkërkuesit e rritur, kjo ishte rreth dy herë më shumë se në vitin 2021. Në fakt, rritja e kërkesave të tërhequra tejkaloi rritjen e kërkesave të paraqitura nga të miturit e pashoqëruar. Kërkesat u tërhoqën kryesisht nga një grup i veçantë: 95% ishin azilkërkues meshkuj të moshës 14-17 vjeç. Pothuajse të gjitha tërheqjet ishin të nënkuptuara, duke sugjeruar që të miturit e pashoqëruar nuk e njoftuan autoritetin për qëllimin e tyre për të tërhequr kërkesën. Është e mundur që tërheqje të tilla tregojnë lëvizje dytësore drejt vendeve të tjera të BE+.





Një numër rekord i të miturve të pashoqëruar që parashetrojnë kërkesë në Austri, Bullgari, Qipro, Francë dhe Holandë

Figura 4. 10 vendet kryesuese të BE+ për marrjen e kërkesave nga të mitur të pashoqëruar, 2022



Shënim: Mungonin të dhënat për Islandën.

Burimi: Eurostat [[migr_asyunaa](#)] sipas të dhënave deri më 13 prill 2023.

Rritja e numrit të fëmijëve të pashoqëruar krahasuar me vitin 2021 ka ushtruar presion shtesë në proceset përkatëse, si caktimi i kujdestarit dhe vlerësimi i moshës së të miturve të vetëshpallur. Rritja ndikoi gjithashtu në afatet kohore për përpunimin e kërkesave dhe ofrimin e kushteve të përshtatshme materiale të pritjes dhe mbështetjes për të miturit e pashoqëruar.



Vërejtjet përfundimtare

Në vitin 2022, vendet e BE+ morën një numër rekord personash që kishin nevojë për mbrojtje, siç dëshmohet nga një numër në rritje të shpejtë të azilkërkuesve dhe mbi 4 milionë personave të shpërngulur nga Ukraina që kërkonin mbrojtje të përkohshme. Ndërsa shifra e kombinuar prej 5 milionë personash që mbërrinin në BE ushtron presion të konsiderueshëm mbi administratat kombëtare, u krijuan zgjidhje në nivel evropian dhe kombëtar për të përmbushur nevojat e njerëzve që kërkonin mbrojtje.

Përgjigjja evropiane ndaj nevojave të miliona personave të shpërngulur nga Ukraina ishte konstruktive dhe e orientuar drejt mbrojtjes, dhe ato mund të shërbejnë si një plan politik dhe operacional për të ardhmen. Një sërë faktorësh e përshpejtuan këtë sukses, duke përfshirë legjislacionin që ka qenë paraprakisht në fuqi që ka qenë i krijuar për të përmbushur në mënyrë specifike këtë nevojë, si dhe vullnetin politik për të aktivizuar këtë legjislacion dhe për të ngritur me shpejtësi strukturat mbështetëse përkatëse. Ajo çfarë është më e rëndësishme, se bashkëpunimi midis aktorëve të shumtë dhe të ndryshëm mbi bazën e solidaritetit të shumanshëm luajti një rol të madh në hartimin dhe ofrimin e zgjidhjeve: solidariteti ndaj personave që kanë nevojë për mbrojtje; solidariteti në vendet e BE-së; dhe solidariteti mes aktorëve të ndryshëm që arritën të mobilizojnë burimet dhe të tërhiqen drejt të njëjtit drejtim. Institucionet dhe agjencitë e BE-së, autoritetet kombëtare dhe vendore, organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, si dhe qytetarët dhe komunitetet private, u mblodhën dhe ndërthurën ekspertizën e tyre përkatëse në ofrimin e zgjidhjeve efektive.

Për të çuar përpara optimizimin e sistemeve të azilit të BE-së në vitin 2022, Presidenca franceze dhe ajo çeke e Këshillit të BE-së morën një qasje graduale, arritën të përshpejtojnë përparimin në negociatat për Paktin për Migracionin dhe Azilin dhe nxitën më tej bashkëpunimin praktik midis shteteve anëtare. Kjo punë kulmoi me miratimin e mandateve të negociatave për Rregulloret e Skriningut dhe Eurodac-ut, në marrëveshjen politike midis bashkë-ligjvënësve për një udhërrëfyes të përbashkët për negociatat për pakon e reformave dhe në marrëveshjen për Mekanizmin e Solidaritetit Vullnetar. Këto rritje të angazhimit, bazuar në një ekuilibër midis shprehjeve të solidaritetit dhe përgjegjësisë, mund të kenë një efekt kumulativ pozitiv, duke informuar më tej politikëbërjen dhe përfundimisht duke lehtësuar miratimin e paktit në vitet e ardhshme.

Në sfondin e përparimeve të tilla në reformën e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit, BE-ja dhe Shtetet e saj Anëtare janë përpjekur të arrijnë integritetin e dyfishtë, domethënë integritetin në procedurën e azilit dhe integritetin e menaxhimit të kufijve. Në fakt, gjatë viteve të fundit, ka pasur një theks në një qasje efektive, e cila është paraqitur si një element thelbësor i metodës për të përmirësuar paktin. Një objektivi i deklaruar i rishikimit të sistemit të Shengenit është rritja e rezistencës ndaj kërcënimeve serioze, siç është instrumentalizimi i emigrantëve, nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve. Në të njëjtën kohë, menaxhimi efektiv kërkon integritet në pritjen e personave që kanë nevojë për mbrojtje në respekt të plotë të të drejtave themelore dhe përpunimin e kërkesave në mënyrë të drejtë dhe dinjitoze.

Kështu, gjatë modernizimit të menaxhimit të kufijve, është thelbësore të garantohet qasje e papenguar në mbrojtje për ata që kanë nevojë. Ndërkohë që janë nisur hapat kryesore në këtë drejtim, si diskutimi – dhe udhëzimet shoqëruese – për ngritjen e mekanizmave të pavarur kombëtare për monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në kufijtë e jashtëm,





raportet alarmante nga organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile ngrenë shqetësime rreth praktikave që pengojnë qasjen efektive ndaj mbrojtjes.

Për të garantuar interpretimin e saktë të CEAS-it, Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GjED) si dhe institucionet gjyqësore në nivel kombëtar vazhduan të shqyrtojnë legjislacionin, politikat dhe praktikat kombëtare në një sërë fushash të lidhura me CEAS-in në vitin 2022. Theks i veçantë u vu në zbatimin e parimit të moskthimit dhe qasjes efektive në territor dhe në procedurën e azilit. Për të ruajtur integritetin e CEAS-it, është shumë e rëndësishme që autoritetet kombëtare t'i zbatojnë vendimet e nxjerra nga gjykatat për këtë qëllim.

Në një tablo azili që ndryshon me shpejtësi, e cila kërkon bashkëpunim të shumë palëve në hartimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të mbrojtjes, EUAA-ja ka evoluar në një komponent jetik të një arkitekture evropiane të azilit. E pajisur me mandatin e saj të përforcuar, Agjencia do të vazhdojë ta mbështesë zbatimin e CEAS-it në të gjithë Evropën. Së bashku me mbështetjen teknike, operacionale dhe të trajnimit e ofruar nga Agjencia, pozicioni i ri i Zyrtarit të pavarur për të Drejtat Themelore do ta përshpejtojë punën për t'u siguruar që të drejtat e azilkërkuesve të mbrohen gjithmonë. Përmes Mekanizmit të saj monitorues, Agjencia do të punojë edhe më afër me shtetet anëtare në vitet e ardhshme për të monitoruar zbatimin operacional dhe teknik të detyrimeve ligjore të BE-së dhe për të ndihmuar shtetet anëtare në identifikimin e kufizimeve të mundshme në sistemet e azilit dhe pritjes, duke kontribuar përfundimisht në një sistem azili më të harmonizuar të BE-së.



Raporti për azilin 2023: Përmbledhje ekzekutive

Si burim kryesor i informacionit për mbrojtjen ndërkombëtare në Evropë, *Raporti për azilin 2023* ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse për zhvillimet kryesore në fushën e azilit në vitin 2022. Përmbledhja ekzekutive është versioni i shkurtuar i raportit kryesor.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) mbledh informacione për të gjitha aspektet e Sistemit të Përbashkët Evropian për Azilin. Për këtë qëllim, raporti ravijëzon ndryshimet në politika, praktika dhe legjislacionin. Raporti paraqet prirjet në azil, treguesit kryesorë për vitin e referencës 2022, një pamje të përgjithshme të sistemit të Dublinit i cili përcakton shtetin anëtar përgjegjës për trajtimin e çështjes dhe seksionin e dedikuar për azilkërkuesit me nevoja të veçanta, duke përfshirë të miturit e pashoqëruar. Shembujt e jurisprudencës janë paraqitur për të interpretuar legjislacionin evropian dhe kombëtar në kontekstin *acquis* së BE-së për azilin.

Raporti për azilin 2023 mbështetet në informacione nga një gamë e gjerë burimesh – duke përfshirë perspektivat nga autoritetet e vendeve, institucionet e BE-së, organizatat e shoqërisë civile dhe mjedisi akademik – për të dhënë një pamje të plotë dhe perspektiva të ndryshme. Raporti, i cili mbulon periudhën 1 janar-31 dhjetor 2022, shërben si referencë për zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare në Evropë.